REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 139/17
Datë/Datum. 12.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **Agjencinë Kadastrale të Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **60100-17-005-211**

Sa i përket tenderit për_ **Rindërtimi i informacioneve kadastrale në 15 zona kadastrale Komunat Drenas , Kamenicë dhe Viti**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Nsh" Geo-Map"&"Consult Engineering" Shpk

Rr. Sali Nivica Prishtinë

049/499499

Florent Emini

Email:geomapks@gmail.com

N.SH. GEO-MAP PRISHTINE

N.SH. "GEO-MAP" & "CONSULT ENGINEERING" KAÇANIK

12.05.2017

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	X				**Jo**	

Me daten 24.04.2017, kemi pranuar nje Leter njoftimi nga AK per eleminimin tone, me te cilin arsyetim nuk jemi pajtuar. Do ju bashkangjesim edhe Letren e njoftimit nga AK dhe sqarimet. Kërkesën për rishqyrtim e kemi bërë me dt:28.04.2017

Përgjigjien ndaj kërkesës për rishqyrtim dt.05.05.2017

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

* **AK ka bërë shkelje te këtyre dispozitave ligjore:**

1. **Nenin 1 të LPP-së**
2. **Nenin 56 të LPP-së**
3. **Neni 59 të LPP-së**
4. **Neni 62 të LPP-së**
5. **Neni 72 të LPP-së**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderuar ,
Me date 28.04.2017 ne kemi bëre kërkesë për rishqyrtim pran AK , në përgjigjien e dhëne nga AK nuk kemi pranuar ndonje përgjigjie të qarte apo vendim ne lidhje me pranimin e apo refuzimin e kërkesë për rishqyrtim po vetem disa spjegime ne lidhje me kërkesat tona ,AK ne përgjigjigjiet e dhëna nuk jan mirrur me pikat e ankeses por kan bere spiegime te pa qendrushme, ne mendojm se është një shkelj.

Të nderuar kërkojmë nga OSHP që ta shqyrtoni drejtë dhe në mënyrë objektive këtë Ankes, pasi që asnjëra nga arsyet e eliminimit tonë nuk është e qëndrueshme.
Në letrën standarde për tenderues të eliminuar AK ka cekur se nuk e kemi përmbushur kërkesën në lidhje me menaxherin e projektit dhe udhëheqësin e projektit ndërsa në përgjigjen e dt:25.04.2017 të dhënë nga zyrtarja e AK na thuhet se jemi eliminuar për faktin se CV e dorëzuara nuk i përmbushin kërkesat për 3 anëtarë të stafit kyç profesional si në vijim:
Faton Bajselmani
Ferid Ahmeti
Fjolla Zurnaxhiu

Pra vetë autoriteti kontraktues është treguar shumë kundërthënës dhe subjektiv lidhur me arsyen tonë të eliminimit.
Ne si konzorcium i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit e poashtu edhe për inxhinierët e lartpërmendur janë bashkangjitur dëshmitë si psh referencat, diplomat dhe CV. Prandaj arsyet e eliminimit tonë janë të pabaza dhe subjektive duke mos u respektuar neni 59 i Ligjit për prokurim publik, pra ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë sipas nenit të lartcekur.
Me rastin e eliminimit tonë nuk është respektuar edhe neni 56 i Ligjit për prokurim publik paragrafi 3 pasi që aty thuhet që asnjë tenderues nuk mund të eliminohet për ndonjë kërkesë që nuk ëhstë e parashikuar në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë, kurse në dosje të tenderit si dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar edhe CV e inxhinierëve kurse asnjë fjalë nuk është shënuar dhe sqaruar më tepër se si duhet të jetë CV e një inxhinieri dhe se çka duhet të përmbajë. Pra ne jemi eliminuar për kërkesa që s'kanë qenë në dosje të tenderit faktikisht ne nuk dimë se çka nuk përmbushin CV e inxhinierëve tonë. Këto arsye të eliminimit janë të pabazuara prandaj edhe janë shënuar duke u përpjekur për të krijuar një konfuzitet mirëpo këtu s'mund të krijohet konfuzitet pasi që kërkesat janë të qarta dhe përmbushja e këtyre kërkesave nga ana e konzorciumit tonë janë të qarta. Autoriteti kontraktues në këtë rast nuk ka marr parasysh dhe i ka dhënë më shumë peshë CV se sa referencave, e që ne i kemi të gjitha. Edhe nëse eventualisht do të mungonte ndonjë CV ose nuk do ti përmbushte ndonjë kusht atëherë kjo do të konsiderohej një devijim i vogël. Kështu që AK nuk e ka respektuar edhe nenin 1 të Ligjit Për prokurim publik e ku thuhet që : Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë".

Duke na eliminuar neve në mënyrë të kundërligjshme autoriteti kontraktues ka ardhur në përfundim për të anuluar këtë aktivitet të prokurimit në mënyrë kundërligjore vetëm për mos të shpallemi ne fitues dhe me këtë rast e ka cenuar dhe shkelur nenin 62 të Ligjit për

prokurim publik dhe nenin 44.7 të rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurim publik pasi që aty thuhet se një ndër arsyet e eliminimit është mungesa e ofertave të përgjegjshme, ndërsa në këtë rast ne jemi të përgjegjshëm.

Edhe nëse AK ka pasur ndonjë paqartësi eventuale në lidhje me dëshmitë dhe dokumentet tona atëherë konform nenit 72 të Ligjit për prokurim publik ka mundur dhe është dashur të na kërkon sqarime shtesë pasi që neni 72 lejon një gjë të tillë por AK as që e ka marr mundin të vepron në këtë mënyrë (edhe pse gjithçka është në rregull sa i përket dokumenteve tona).

Kërkojmë nga OSHP që të shqyrtohet vedimi për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit nga AK dhe lënda të kthehet në rivlersim dhe ne si OE të shpallemi fitues pasi qe i polotsojm të gjitha kërkesat të kerkuar ne DT.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Dëmi material për kompaninë vetëm për përgatitjen e dosjes është në vlerën prej 250.00 Euro , dhe fitimi i realizuar pas përfundimit të kësaj kontrate.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*